



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 637/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.09.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt: “*Vendosje e sinjalistikës rrugore*”, me nr. REF-19638-07-05-2017, me fond limit 2.317.967 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.07.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Ura Vajgurore.

Ankimues: “SI.SI-AL” sh.p.k.
Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës Km 4, përballë BMË.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Ura Vajgurore
Adresa: Rruga Dimal, Lagja “18 Tetori”.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3 Nuk ka respektuar formën ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.07.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt: “*Vendosje e sinjalistikës rrugore*”, me nr. REF-19638-07-05-2017, me fond limit 2.317.967 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.07.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Ura Vajgurore.

II.2. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ dhe parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, operatori ekonomik “SI.SI-AL” sh.p.k., në datën 11.07.2017 ka paraqitur ankesë me anë të portalit të dërgimit të mesazheve të Sistemit të Prokurimeve Elektronike (S.P.E.), me anë të së cilës kërkon modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, dhe informacionit të marrë nga autoriteti kontraktor, ky i fundit nuk ka marrë në shqyrtim ankesën dhe nuk i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “SI.SI-AL” sh.p.k.

II.4. Në datën 14.08.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Në datën 18.08.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “SI.SI-AL” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 06.07.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt: “*Vendosje e sinjalistikës rrugore*”, me nr. REF-19638-07-05-2017, me fond limit 2.317.967 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.07.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Ura Vajgurore.

III.2. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ dhe parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, operatori ekonomik “SI.SI-AL” sh.p.k., në datën 11.07.2017 ka paraqitur ankesë me anë të portalit të dërgimit të mesazheve të Sistemit të Prokurimeve Elektronike (S.P.E.), me anë të së cilës kërkon modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.3. Bazuar në informacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit argumenton se nuk ka marrë në shqyrtim ankesën pasi operatori ekonomik “SI.SI-AL” sh.p.k. nuk ka respektuar formën ligjore të paraqitjes së ankesës në lidhje me procedurat e prokurimit elektronik.

III.4. Në datën 17.07.2017 autoriteti kontraktor Bashkia Ura Vajgurore zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

III.5. Në datën 24.07.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.6. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 11.08.2017 ka lidhur kontratën me të vetmin operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, i cili pasi plotësoi kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor është shpallur fitues “Totila” sh.p.k.

III.6. Në datën 14.08.2017, autoriteti kontraktor pas publikimit të lidhjes së kontratës ka arkivuar procedurën objekt prokurimi.

III.7. Në datën 14.08.2017, operatori ekonomik ankimues “Si.SI-AL” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit.

III.7.1 Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pikën 1.1, pikën 5 dhe pikën 6 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin thuhet shprehimisht se:

“1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.7.2. Në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Si.Si-Al” sh.p.k. pranë autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se ankesa e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor është dërguar me anë të portalit të dërgimit të mesazheve të Sistemit të Prokurimeve Elektronike (S.P.E.). Referuar *lex specialis* LPP, neni 63 pika 1 ku parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.” Gjithashtu, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 78 pika 6 ç) ku shprehimisht përcaktohet se: “Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave. Në çdo rast, vendimi i autoritetit kontraktor i komunikohet me

shkrim ankimesit. Për efekt të shkurtimit të afateve kohore të procesit të ankimit, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës komunikon vendimin ankimesit edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së vendimit”.

Në nenin 3 “Përkufizime”, pika 22 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “Komunikimi me shkrim” është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë edhe informacionet, që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike”. Në nenin 22 të LPP-së parashikohet se: “I gjithë dokumentacioni, njoftimet, vendimet, informacionet dhe komunikimet e parashikuara në këtë ligj bëhen me shkrim ose me mjete elektronike”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ligjvënësi megjithëse ka parashikuar si formë të komunikimit me shkrim, edhe të dhënat e transmetuara në mënyrë elektronike ka veçuar në mënyrë eksplicite komunikimin me mjete elektronike, duke përfshirë një sërë elementësh të procesit të zhvillimit të procedurës së prokurimit publik si Publikimi i Njoftimit të Kontratës, dorëzimi dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, vlerësimi i ofertave të dorëzuar nga operatorët ekonomikë etj., por në asnjë rast nuk ka parashikuar paraqitjen e ankimit administrativ me mjete elektronike. Akoma më tej, K.P.P. gjykon se dorëzimi i ankesës me mjete elektronike nuk gjen zbatim në kuptim të LPP-së. Akoma më tej, K.P.P. gjykon që komunikimi me anë të dokumentit elektronik të përmbushë kushtet e vlefshmërisë së tij, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.10273 datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, i cili njëherazi duhet të jetë administruar, protokolluar pranë insitucionit përkatës në përputhje me VKM nr.357 datë 24.04.2013 “Për miratimin e rregullores “Për menaxhimin e dokumentit elektronik në Republikën e Shqipërisë”.

III.7.3. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i formës ligjore të ankesës, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimes pranë autoritetit kontraktor me anë të komunikimit elektronik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik përkatësisht datë 14.08.2017 nuk legjitimohet pasi operatori ekonomik nuk ka ezauruar të gjitha shkallët që duhet të ndjekë një ankim administrativ parashikuar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Si.Si-Al” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me objekt: “Vendosje e sinjalistikës rrugore”, me nr. REF-19638-07-05-2017, me fond limit 2.317.967 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.07.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Ura Vajgurore.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1376 Protokoli,
Datë 14.08.2017

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi



Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha